

University of Business and Technology in Kosovo

**UBT Knowledge Center**

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Winter 1-2021

## **HIPERTENSIONI**

Artinë Thaçi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>

 Part of the **Nursing Commons**

---



Kolegji UBT

Fakulteti i Infermierisë

## **HIPERTENSIONI**

Shkalla Bachelor

Artinë Thaçi

Janar/ 2021  
Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti Infermierisë

## **Punim Diplome**

Viti akademik 2016/2017

## **HIPERTENSIONI**

Mentori:  
Dr. Sci. Masar Gjaka

Janar/ 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallë Bachelor

## ABSTRAKT

Në ditët e sotme si pasojë e dinamikës së tepërt, një sëmundje si hipertensioni kërkon shumë vëmendje dhe një kujdes të shtuar. Si studente dhe si një infermiere e ardhshme konsideroj të arsyeshme që për trajtimin e kësaj sëmundje është e rëndësishme të shqyrtohen me kujdes mënyrat më të mira që të mënjanohen vështirësitë gjatë trajtimit të kësaj sëmundje.

Pikësypnim i një sistemi të rregullt, dhe të sigurt shëndetësor duhet që promovimi i shëndetit të mirë të jetë hallkë kryesore në mënyrë që të evitohen problemet e rëndësishme shëndetësore, e kjo vë në rëndësi edhe promovimin e një sëmundje si hipertensioni, mënyrat se si mund të parandalohet atë, të lehtësojmë dhimbjet, si dhe të kuptojmë mënyrat më efektive për një trajtim jo shumë të vështirë për pacientin por edhe për profesionistin shëndetësor.

Për diagnostifikimin, trajtimin e kësaj sëmundje nevojitet përkushtim nga pacienti në kuadër të pajtimit me kriteret dhe këshillimin nga profesionistët shëndetësor duke përfshirë ndryshimin e stilit të jetesës, kujdesit me medikamente e elemente tjera të cilat kanë ndikim primar në trajtimin e hipertensionit.

Fjalët kyçe: Hipertensioni, shkaqet, parandalimi, trajtimi.

## MIRËNJOHJE/FALËNDERIME

Gjatë këtij rrugëtimi tre vjeçar të studimit të degës së infermierisë përjetimet e mia do të mbeten një pjesë shumë e rëndësishme dhe kuptimplote në jetë.

Falenderoj përzemërsisht dhe shprehë mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe kanë ofruar mbështetje të pakushtëzuar gjatë këtyre viteve studimi. Në rend të parë, falenderimi i takon Allahut për çdo gjë, familjes për të gjitha mundësitë e krijuara si dhe për praninë e tyre në çdo moment të jetës time.

Gjithashtu shprehë mirënjohje edhe për profesorët të cilët kanë qenë gjithmonë pranë dhe janë përpjekur që gjithë dijen e tyre të na dhurojnë ne studentëve.

Falenderim i veçantë shkon për mentorin Dr.Sc. Masar Gjaka për mbështetjen dhe për kontributin e dhënë gjatë përpilimit të temës së diplomës.

Faleminderit shumë!

# PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE.....	VI
LISTA E FIGURAVE.....	VII
HYRJE .....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	2
2.1 Shkaqet e Hipertensionit.....	3
2.1.1 Pirja e duhanit.....	4
2.1.2 Obeziteti.....	4
2.1.3 Alkooli .....	4
2.1.4 Stresi .....	5
2.1.5 Historia pozitive familjare .....	5
2.1.6 Dieta ushqimore e varfër .....	5
2.1.7 Roli i kalciumit .....	5
2.1.8 Sëmundjet e veshkave.....	6
2.1.9 Çrregullimet e gjëndrave tiroide.....	6
2.2 Simptomat e hipertensionit .....	6
2.2.1 Presioni sistolik dhe diastolik.....	6
2.2.2 Hipertensioni tek moshat e reja .....	6
2.2.3 Hipertensioni tek të moshuarit.....	7
2.2.4 Hipertensioni në shtatëzani.....	7
2.2.5 Llojet e hipertensionit .....	7
2.2.6 Hipertensioni thelbësor-primar .....	8
2.2.7 Hipertensioni sekondar .....	8
2.2.8 Komplikimet nga hipertensioni .....	8

2.2.9 Parandalimi i hipertensionit.....	9
2.3 Monitorimi i presionit të gjakut.....	10
2.3.1 Stadet e hipertensionit.....	10
2.3.2 Analizat per diagnostifikimin e hipertensionit .....	11
2.3.3 Menaxhimi infermieror tek pacientët me hipertension.....	11
2.3.4 Trajtimi farmakologjik i hipertensionit .....	12
2.3.5 Trajtimi jo- farmakologjik i hipertensionit.....	12
2.3.6 Kufizimi i Alkoolit .....	12
2.3.7 Ndryshimet Dietare.....	13
2.3.8 Humbje peshe .....	13
2.3.9 Moskonsumi i duhanit .....	13
2.4 Produktet detare .....	13
2.4.1 Meditimi .....	13
2.4.2 Aktiviteti fizik.....	14
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT .....	15
4. METODOLOGJIA .....	16
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE .....	17
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	25
7. REFERENCA .....	27
8. APPENNDIXES .....	36

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1:Struktura gjinore .....	17
Tabela 2:Konsumimi i ushqimit.....	17
Tabela 3:Gjendja momentale shëndetësore.....	18
Tabela 4:Aktiviteti fizik.....	19
Tabela 5: Medikamentet.....	20
Tabela 6:Mënyrat e mbajtjes së rregulltë të numrave .....	21
Tabela 7: Konsumimi i Alkoolit.....	22
Tabela 8:Stresi.....	23



## LISTA E FIGURAVE

Figura 1:Komplikimet nga hipertensioni.....	9
Figura 2:Stadet e presionit të gjakut.....	11
Figura 3:Struktura gjinore .....	17
Figura 4:Konsumimi i ushqimit .....	18
Figura 5:Gjendja momentale shëndetësore .....	19
Figura 6:Aktiviteti fizik .....	20
Figura 7:Medikamentet .....	21
Figura 8:Mënyrat e mbajtjes së rregulltë të numrave.....	22
Figura 9:Konsumimi i Alkoolit .....	23
Figura 10:Stresi .....	24

## HYRJJE

Si pasojë e ndryshimit të stilit të jetës së njeriut, sëmundjet të cilat në kohët e lashta kanë egzistuar në masë më të vogël, në këto kohë po mbizotërojnë. Në këtë punim diplome do të elaboroj më shumë rreth hipertensionit si sëmundje shumë e pranishme në jetën e njeriut. Në pjesën e parë do të shtjellohen disa pjesë teorike në kuadër të hipertensionit duke ofruar informata bazike se çka është hipertensioni, si manifestohet, dhe si bëhet trajtimi i tij. Në pjesën e dytë do të shtjellohen analiza, si dhe do ofrohen rekomandime me bazë shkencore. Duke marrë parasysh problemet dhe nevojat e personave të prekur me hipertension, është e rëndësishme të dihet se çfarë lloj ndryshimesh nevojiten në stilin e jetës në mënyrë që kualiteti i jetës të ngritet si dhe të minimizohen dhimbjet dhe problemet që shkaktohen nga kjo sëmundje. Në fund do të prezantoj disa të dhëna origjinale të cilat janë mbledhur përmes pyetësorëve nga disa persona në komunën e Malishevës. Ky pyetësor i është referuar stilit të jetës së qytetarëve në këtë komunë. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë promovimi i një stili jetësor sa më të shëndetshëm, duke vënë theks dhe rëndësi të veçantë në metodat për menaxhim më të mirë të hipertensionit si dhe inkurajimin e pacientëve për të iu përmbajtur këshillave, rekomandimeve të cilat ndikojnë pozitivisht në lehtësimin e simptomave, dhe trajtimit të hipertensionit.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Zbulimi i hipertensionit përkon që nga fillimi i viteve 1870, ku Frederick Mahomed i cili ishte pjesë e repartit mjekësor në spitalin Guy në Londër, bëri matjen e shtypjes së gjakut në popullatën e përgjithshme. Gjatë punës me një orëndreqës ai montoi një pajisje e cila mundësonte matjen e shtypjes së pulsit radial, një version portativ i spigmografit i shpikur në Francë. Pasi që pacientët me sëmundje të veshkave kishin një presion të lartë të gjakut, ai në kuadër të matjes zbuloi një nëngrup të popullit që kishte presion të lartë si pasojë e mungesës së proteinave (Mahomed, 1874). Edhe pas zbulimit të Mahomed, matja e presionit të gjakut nuk aplikohet shumë deri në vitet 1890 ku Scipione Riva-Rocci (1863-1937) zbuloi manzhetën dhe manometrin e merkurit. Korotkoff zbuloi metodat auskultative të matjes (Faught, 1914). Presioni i gjakut është esencial për jetë, çdo organizëm duhet të përmbajë një sasi të mjaftueshme të gjakut për të mbajtur qarkullimin e tij. Pa sasinë adekuate gjaku nuk mundet të furnizojë qelizat me oksigjen dhe nutrientë të cilat nevojiten për jetë (Komaroff, 2005). Presioni i lartë i gjakut apo hipertensionit paraqet gjendjen në të cilën presioni i gjakut në arterie është shumë i lartë gjë e cila ndodhë për arsye të ndryshme. Zakonisht presioni i lartë i gjakut nuk shkakton simptoma deri në masën në të cilën e dëmton organizmin, për këtë arsye quhet edhe vrasës i heshtur por nëse zbulohet me kohë, mund të parandalohet. Presioni i lartë shkaktohet kur zemra pompon gjakun me një forcë më të lartë dhe në këtë rast ndodh ngushtimi i arteriolave duke krijuar një rezistencë në qarkullimin e gjakut . Prania e presionit të lartë të gjakut tregon një përgjigje të organizmit në të cilën shtohet kërkesa e organizmit për gjak dhe nutrientë (Komaroff ,2005). Hipertensionit është çrregullim progresiv që rrjedh nga etiologjitë komplekse dhe të ndërlydhura në mes vete. Simptomat e hipertensionit shpesh paraqiten në fazën para vlerës kulminante të presionit të gjakut. Ky proces nëse shoqërohet me anomali funksionale, strukturore të zemrës dhe enëve të gjakut të cilat dëmtojnë zemrën, veshkët, trurin, dhe organet tjera, si dhe shkaktojnë sëmundje të parakohshme dhe vdekje (Giles, Berk, & Black, 2005). Qëllimi i trajtimit të hipertensionit është ulja e presionit të gjakut në <math><140/90\text{ mmHg}</math> megjithatë, në pacientët me hipertension dhe diabet ose sëmundje renale, qëllimi i synuar i vlerave të presionit të gjakut është edhe më i ulët në <math>\leq 130 / 80\text{ mmHg}</math>. Në kuadër të trajtimit përveç trajtimit farmakologjik, ndërhyrjet jofarmakologjike duhet të

aplikohen në të gjithë pacientët me hipertension. Modifikimet e stilit të jetës mund të ulin rreziqet e tjera të sëmundjes dhe mund të shmangin nevojën për terapi me barna. Mbajtja e një jetese të shëndetshme, sidoqoftë nuk është e mjaftueshme ose është e vështirë të respektohet dhe shumica e pacientëve kërkojnë ndërhyrje farmakologjike për të kontrolluar presionin e gjakut (Chobanian, Bakris, & Black, 2003).

## 2.1 Shkaqet e Hipertensionit

Në shoqëritë bashkëkohore, nivelet e presionit të gjakut janë më të ngritura në varësi të ndryshimit të moshës si te meshkujt ashtu edhe tek femrat. Ky zbulim mund të shpjegohet për faktin se moshja është faktor për probabilitetin dhe kohëzgjatjen e ekspozimit ndaj faktorëve të shumtë që ngritin presionin gradualisht siç janë konsumimi i tepërt i natriumit, marrja e pamjaftueshme e kaliumit, mbipesha, alkooli dhe faktorët si predispozita gjenetike, mjedisi jo i favorshëm intrauterine, janë shkaqe të cilat ndikojnë në sëmundjen e hipertensionit (Poulter, Prabhakaran, Caulfield & Lancet, 2015). Mekanizmat patofiziologjikë për hipertensionin janë kompleks dhe veprojnë në suaza gjenetike hipertensionit primar përfshin lloje të ndryshme të gjeneve, të cilat në shumicën e rasteve shoqërohen me rrezikun e zhvillimit të hipertensionit primar dhe lidhen me rastet me histori pozitive familjare (Hall, 2018). Probabiliteti i shfaqjes së hipertensionit rritet së bashku me moshën, për shkak të ngurtësimit progresiv të arterieve, ndryshimi në kolagenin vaskular dhe ateroskleroza (Mikael, Paiva, Gomes, Sousa, Jardim, Vitorino, Euzébio, Sousa & Barroso, 2017). Faktorët imunologjikë luajnë rol të madh e sidomos në sëmundjet infektive dhe reumatologjike ku lidhshmëria me sëmundjet hipertensive paraqet patofiziologjinë shumëpërfshirëse (J Am Med Assoc, 1949). Sipas zbulimeve shumica e të prekurve amerikanë me presion të ngritur të gjakut nuk kanë ndonjë shkak të identifikueshëm për sëmundjen e hipertensionit, një përqindje e vogël shoqërohet me shkaqet si sëmundjet renale, parenkimale, rinovaskulare, sëmundjet e veshkave, koartakcioni i aortës, sindroma cushing, apnea e gjumit, medikamentet, feokromocitoma, hiperaldosteronizmi primar, sëmundja e tiroideve (Chobanian, Bakris, Black, Cushman, Green, Izzo, Jones, Materson, Oparil, Wright & Roccella, 2003).

### **2.1.1 Pirja e duhanit**

Pirja e duhanit klasifikohet një problem dhe shkak i cili prek personat me hipertension, pasi ndikon në cilësinë dhe zvogëlimin e jetës. Konsumi i duhanit në përgjithësi ka një efekt afatgjatë në shëndet, kështu që aktualisht mund të mos dëmtojë shëndetin menjëherë dhe duhanpirësit të shërohen nga dëmtimet e shkaktuara (Slovic, 2000). Pirja e duhanit mund të prodhojë një eksitim të përkohshëm që krijon një vlerësim optimist të gjendjes shëndetësore, dhe nëse konsumohet vazhdimisht mund të maskojë më tej simptomat e hershme të paralajmërimit të disa sëmundjeve për këtë arsye është shumë e preferueshme që të mos konsumohet (Garten, 2003).

### **2.1.2 Obeziteti**

Obeziteti rrit sekretimin e insulinës, një hormon që rregullon sheqerin në gjak. Insulina mund të shkaktojë trashje të enëve të gjakut dhe për rrjedhojë një rritje të rezistencës periferike, tek njerëzit obez shpërndarja e yndyrës në trup është e rëndësishme, sepse një raport më i lartë i belit shoqërohet me mundësi më të mëdha të shfaqjes të hipertensionit (Ramaiah, 2012). Në bazë të studimeve, vlerësimet tregojnë se shkaktarë mjaft ndikues është mbipeshja (Krause, Winston, Fletcher & Grundy, 1998). Mbipeshja ka treguar problematikë edhe në sëmundjet e arterieve koronare, në apne, goditjen në tru dhe dështimin e zemrës (Haslam & James, 2005).

### **2.1.3 Alkooli**

Egzistojnë shkaktarë të ndryshëm të cilët zhvillojnë presion të lartë të gjakut, ndër këta faktorë është konsumimi i alkoolit (MedlinePlus, 2017). Nëse një individ konsumon një pije të vetme alkoolike, ajo shkakton ngritje akute të presionit të gjakut e cila nuk merret ndonjëherë serioze dhe sidoqoftë kjo zakonisht nuk shkakton probleme afatgjate (Maheswaran, Ravi, Jaswinder, Singh, Davies, Paul, Gareth, & Beevers, 2019). Alkooli përmban shumë kalori dhe sheqer, konsumi i tij ndikon edhe në peshën e trupit (Köchli, Sabrina, Endes, Katharina, Steiner & Ramona, 2018).

#### **2.1.4 Stresi**

Stresi mund të shkaktojë hipertension si pasojë e ngritjeve të përsëritura të presionit të gjakut, si dhe nga stimulimi i sistemit nervor për të prodhuar sasi të mëdha të hormoneve vazokonstrikuese duke e ngritur presionin e gjakut. Ndonjëherë kur një faktor rreziku shoqërohet me faktorë të tjerë stresues, efekti në presionin e gjakut shumëfishohet (Kulkarni, Farrell, Erasi, & Kochar, 1998).

#### **2.1.5 Historia pozitive familjare**

Historia familjare pozitive paraqet një faktor mjaft të rëndësishëm në sëmundjen e hipertensionit e cila është vërejtur në shumë studime familjare (Barlassina, Lanzani, Manunta & Bianchi, 2002). Me anë të aplikimit të matjes së presionit gjakut ndërmjet motrave dhe prindërve dhe fëmijëve (Carretero & Oparil, 2000). Rreth 30% e variancës së tensionit të gjakut mund t'i atribuohet faktorëve gjenetikë (Corvol, Jeunemaitre, Charru & Soubrier, 1992) dhe u zbulua se probabiliteti i paraqitjes së sëmundjes ishte në 65% në studimet ndër binjakë (Carretero & Oparil, 2000).

#### **2.1.6 Dieta ushqimore e varfër**

Rekomandimet nacionale amerikane dhe ndërkombëtare (James, Oparil, Carter & Cushman, 2014) për administrimin e ndryshimeve të jetës së lartë të presionit të gjakut miratojnë ndryshimet në stilin e jetës, përfshirë humbjen e peshës, aktivitetin fizik të rregullt, mbajtjen e një plani ushqimor të shëndetshëm siç janë (DASH) dieta dhe uljen e marrjes të natriumit (N Engl J Med, 2001).

#### **2.1.7 Roli i kalciumit**

Roli i kalciumit në sëmundjen e hipertensionit mund të kuptohet më së miri nga një model hierarkal, në të cilin efektet e presionit të gjakut të një sinjali varen nga ndryshimet e sistemeve hormonale të veçanta për atë sinjal. Marrja e kalciumit paraqet efekte të lidhura reciprokisht në sisteme hormonale dhe në presionin e gjakut (Lawrence & Resnick, 1999).

### **2.1.8 Sëmundjet e veshkave**

Presioni i lartë i gjakut mund të zhvillohet si pasojë e sëmundjeve kardiovaskulare në shoqërim të përkeqësimit të funksionimit renal i cili shkakton çrregullime në veshkë (Jacobsen, Rossing, Tarnow, Rossing, Mallet, Poirier, Cambien & Parving, 1999).

### **2.1.9 Çrregullimet e gjëndrave tiroide**

Hipotiroidizmi mund të shkaktojë ngritje të tensionit diastolik të gjakut, ndërsa hipertiroidizmi mund të shkaktojë ngritje të tensionit sistolik të gjakut, duke shkaktuar një presion të zgjeruar të pulsit. Përderisa sëmundja e tiroides shfaqet në të gjithë spektrin e moshës, testimi për hipo dhe hipertiroidizëm duhet të konsiderohet nëse ka simptoma sugjeruese të secilës gjendje egzistuese (Klein & Danzi, 2008).

## **2.2 Simptomat e hipertensionit**

Hipertensionit në të shumtën e rasteve është asimptomatik dhe diagnostifikimi i tij ndodh gjatë ekzaminimeve rutinore të cilat preferohen të bëhen, sidomos në raste dyshimi për këtë sëmundje. Simptomat fillojnë të shfaqen kur hipertensionit është në faza të përparuar dhe dëmtimet e tij shtrihen në organet si zemra, veshkat dhe truri (Elling & Caroline, 2007).

### **2.2.1 Presioni sistolik dhe diastolik**

Me presion sistolik kuptojmë tkurrjen e barkushës së majtë e cila pasqyron integritetin e zemrës, arterieve dhe arterioleve. Presioni me vlerat 100-119 mmHg paraqet presion normal sistolik. Presioni diastolik shprehë kohën gjatë të cilës ndodh relaksimi i barkushës së majtë, e cila tregon rezistencën e enëve, vlerat normale të presionit diastolik variojnë nga 60-79 mmHg (Fundamentals of Nursing Made Incredibly Easy, 2007).

### **2.2.2 Hipertensionit tek moshat e reja**

Hipertensionit është sëmundje e cila prek moshat e reja, me një përqindje me 30% (Gillespie & Hurvitz, 2007–2010). Edhe pse mendohet të shfaqet më pak tek fëmijët, kjo sëmundje fillon të manifestohet gjatë zhvillimit të fëmijës (Berenson, Wattigney, Bao, Nicklas, Jiang & Rush, 1994). Presioni i gjakut pëson ndryshime gjatë zhvillimit të moshës, dhe sipas vlerave të

matura janë gjetur që presioni i gjakut ka një gjenezë e cila tregon problemet që mund të shfaqen nga presioni i gjakut në të ardhmen (Bao, Threefoot, Srinivasa & Berenson, 1995).

### **2.2.3 Hipertensioni tek të moshuarit**

Hipertensioni është një sëmundje kronike domethënëse dhe shpesh asimptomatike, e cila kërkon kontroll optimal dhe përdorimin e vazhdueshëm të ilaçeve të përshkruara për të zvogëluar rreziqet e sëmundjeve kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe veshkave (Cardiovasc, 2003). Arteriet pësojnë ndryshim me moshën ato bëhen më elastike, zgjerohen, ngurtësohen dhe për këtë arsye ngritjet dhe uljet e presionit i dëmtojnë ato edhe më shumë si pasojë e ndryshimeve (Rourke & Hashimoto, 2007).

### **2.2.4 Hipertensioni në shtatëzani**

Hipertensioni në shtatëzani, prek deri në 10% të shtatëzanive që është ndërlikim me pasoja si për nënën ashtu edhe për foshnjën (Hypertension in Pregnancy, 2013). Sipas analizave sistematike të kryera nga organizata botërore e shëndetësisë çrregullimet hipertensionale janë ndër shkaktarët e dytë më të zakonshëm të vdekjeve perinatale tek gratë, me një përqindje rreth 14% të nënave në të gjithë botën (Lisowska, Pietrucha & Sakowicz, 2018).

### **2.2.5 Llojet e hipertensionit**

Presioni i lartë i gjakut në të cilën gjendja e krijuar nuk ka ndonjë shkak të ditur njihet si hipertension thelbësor ose primar, kjo është forma më e shpeshtë e hipertensionit. Për të ditur vlerat e presionit të gjakut matja është tipari kryesor në zbulimin e hipertensionit thelbësor (Kulkarni, 1998). Hipertensioni renal rezulton nga sëmundjet e veshkave ose dëmtimi i arterieve të cilat furnizojnë veshkat me gjak për arsye të përjashtimit të substances humerale, reninës e cila prodhohet ne veshkë dhe shkakton shtrëngimin e arterieve renale (Larson, Larson, Cullough, Koenig & McCullough, 2001). Hipertensioni i fshehtë i cili i referohet pacientëve të cilët gjatë monitorimit të vlerave në klinikë presioni i tyre është normal (Bobrie, Clerson, Menard, Postel-Vinay, Chatellier, & Plouin, 2008).



### **2.2.6 Hipertensioni thelbësor-primar**

Hipertensioni parësor apo ndryshe quhet hipertension idiopatik shkaqet e të cilit nuk dihen, dhe për arsye sepse sëmundjet rinovaskulare, dështimi i veshkave, aldosteronizmi nuk janë të pranishme. Hipertensioni thelbësor përfshin 95% të rasteve me hipertension, është çrregullim heterogjen i përbërë nga faktorët e ndryshëm të cilët ndikojnë në ngritjen e nivelit të gjakut. (Oscar, Carretero & Suzanne, 2000).

### **2.2.7 Hipertensioni sekondar**

Hipertensioni dytësor është hipertensioni arterial i shoqëruar me shkaqe, paraqitet me një përqindje të vogël 5-10 % (Chobanian & Vongpatanasin, 2014). Hipertensioni sekondar ndryshon nga mosha dhe zakonisht paraqitet tek personat më të rinj, me një prevalencë 30 % (Chobanian, Bakris, & Black).

### **2.2.8 Komplikimet nga hipertensioni**

Presioni shumë i lartë mund të shkaktojë dëmtime të shumëfishta në organizëm, enët e gjakut si pasojë e presionit të lartë të gjakut ngushtohen duke shkaktuar arteriosklerozën. Nëse ndodhë zgjerimi i aortës ndodhë aneurizmi i aortës, presioni i lartë i gjakut shkakton anginën me rastin e bllokimit të arterieve koronare, duke mundësuar dështimin e zemrës dhe funksionimin e saj si dhe infarktin e miokardit apo muskulit të brendshëm të zemrës. Presioni i lartë ndikon edhe tek veshkët të cilat nëse nuk trajtohen mund të përkeqësojë gjendjen e të sëmurit dhe të shkaktojë çrregullime renale kronike (Weber & Michael, 2014).

## Main complications of persistent High blood pressure




Figura 1:Komplikimet nga hipertensioni

(Häggström, Mikael,2014). Medical gallery of Mikael Häggström 2014 *WikiJournal of Medicine*  
1 (2).

### 2.2.9 Parandalimi i hipertensionit

Parandalimi i presionit të lartë të gjakut arrihet duke e shtuar kujdesin në stilin jetësor. Kjo do të thotë ushqimi i shëndetshëm, aktiviteti fizik, largimi i stresit. Është gjithashtu e rëndësishme të konsumohen ushqime që janë më të ulëta në yndyrë, si dhe shumë fruta, perime dhe drithëra të plota pra në kuptimin gjithëpërfshirës hipertensioni duhet të përcaktohet në terma të një niveli të ruajtjes së presionit të gjakut mbi të cilin vëzhgimi dhe parandalimi sjellin benefite (Evans & Rose, 1971).

## **2.3 Monitorimi i presionit të gjakut**

Monitorimi i cili aplikohet në reparte ambulatorë i presionit të gjakut zhvillohet me teknikën e përdorimit të sfingmomanometërit, stetoskopit dhe dëgjimit të tingujve Korotkoff. Monitorimi ambulator rrit në mënyrë të konsiderueshme rrezikun nga presioni i gjakut (Verdecchia, Porcellati, Schillaci, Borgioni, Ciucci, Battistelli, Guerrieri, Gatteschi, Zampi, Santucci, Santucci, & Reboldi, 1994). Numri i shpeshë i leximeve dhe paragjykimi i vlerave nga ana e pacientëve, efekti i veshjes së bardhë ndikojnë në ngritjen e presionit të gjakut (O'Brien, 2013). Vetëmatja e presionit ndikon në mënyrë pozitive nga largimi i stresit të matjes ambulatorë (Staessen, Thijs, Ohkubo, Kikuya, Richart, Boggia, Adiyaman, Dechering, Kuznetsova, Thien, O'brien & Parati, 2008).

### **2.3.1 Stadet e hipertensionit**

Vlerat normale të presionit të gjakut variojnë ndërmjet 90 dhe më pak se 120 të presionit sistolik dhe vlerave ndërmjet 60 dhe më pak se 80 të presionit diastolik. Nëse këto vlera ndryshojnë për disa numra kemi të bëjmë me ngritje të presionit të gjakut këto lexime shprehen në milimetra të merkurit apo me shkurtesën mmHG (Madel & Marcin, 2020). Hipertensioni varësisht nga gjendja e pacientit klasifikohet në disa stadi. Nëse vlerat e presionit të gjakut janë ndërmjet 130 dhe 139 mmHg të presionit sistolik dhe vlerat ndërmjet 80 mmHg dhe 89 mmHg kemi të bëjmë me hipotensionin e fazës së parë. Faza e dytë e hipertensionit ndodh atëherë kur vlerat tregojnë një numër të lartë sistolik 140 ose më shumë nga presioni sistolik apo 80 mmHg dhe më lart nga presioni diastolik. Vlerat e lexuara të cilat janë më shumë se 180 nga presioni sistolik dhe mbi 120 të presionit diastolik tregojnë problem të madh shëndetësor dhe njihet si krizë hipertensive (Madel & Marcin, 2020).

# Blood Pressure Categories



BLOOD PRESSURE CATEGORY	SYSTOLIC mm Hg (upper number)		DIASTOLIC mm Hg (lower number)
NORMAL	LESS THAN 120	and	LESS THAN 80
ELEVATED	120-129	and	LESS THAN 80
HIGH BLOOD PRESSURE (HYPERTENSION) STAGE 1	130-139	or	80-89
HIGH BLOOD PRESSURE (HYPERTENSION) STAGE 2	140 OR HIGHER	or	90 OR HIGHER
HYPERTENSIVE CRISIS (consult your doctor immediately)	HIGHER THAN 180	and/or	HIGHER THAN 120

[heart.org/bplevels](https://www.heart.org/bplevels)

Figura 2: Statet e presionit të gjakut

<https://www.heart.org/-/media/health-topics-images/hbp/blood-pressure-readings-chart-english.jpg?la=en>

## 2.3.2 Analizat per diagnostifikimin e hipertensionit

Për diagnostifikimin e hipertensionit, testet të cilat rekomandohen janë ekokardiogram testi qe bën matjen e aktivitetit elektrik, shpejtësinë dhe ritmin e rrahjeve të zemrës. Ekokardiogrami gjen mjaft zbatim për sigurimin e fotove të valvulave dhe dhomave të zemrës, në mënyrë që të studiohet funksioni i saj duke e bërë të ditur shkaktarin e sëmundjes (Suzanne & Steinbaum, 2019).

## 2.3.3 Menaxhimi infermieror tek pacientët me hipertension

Shërbimi infermieror tek pacientët me hipertension ka qenë i domosdoshëm gjate 35 viteve të fundit duke përfshirë shërbimet në klinika, vizitat shtëpiake, programit të punës në qendra të kujdesit shëndetësore, si primare, sekondare apo terciare, duke qenë afër pacientit qoftë në kuadrin infermieror apo edukimin dhe këshillimin e pacientëve (Black & Elliott, 2012).

### **2.3.4 Trajtimi farmakologjik i hipertensionit**

Hipertensioni si sëmundje mund të parandalohet në rast se shtohet kujdes dhe kontrollohet në rast se dyshohet për këtë sëmundje (Ezzati, Lopez, Rodgers, Vander & Murray, 2002). Trajtimi me anë të barnave antihipertensive përdoret duke i ndarë ato në shumë kategori varësisht nga fazat e sëmundjeve dhe cilësia që mund të shkaktojnë ato barna duke e përshtatur me simptomat e sëmundjes. Disa analiza nga provat mbi trajtimin hipertensiv rekomandojnë se ACE frenuesit dhe bllokuesit e kanaleve të kalciumit kanë ndikim në zvogëlimin e sëmundjes dhe vdekjen (Neal, Mac, Mahon & Chapman, 2000). Terapia e cila përdoret tek pacientët me hipertension përbëhet nga larmi të shumta kombinimesh qoftë si terapi e veçantë apo e kombinuar të cilat përdoren tek pacientët në bazë të gjendjes së tyre shëndetësore (Garjón, Saiz, Azparren, Elizondo, Gaminde, Ariz, & Erviti, 2017).

### **2.3.5 Trajtimi jo-farmakologjik i hipertensionit**

Trajtimi jo-farmakologjik i referohet të gjithë pacientëve me hipertension, sepse përmes metodave të ndryshme studimet tregojnë se mund të përmirësojnë gjendjen në mënyrë ekuivalente me barërat (Mancia, 2013). Këta parametra paraqesin një balancim dhe efekt të dobishëm jo-farmakologjik. Ndryshimet në stilin e jetës, ushtrimet, dieta kanë rezultuar në përmirësim në nivelin sistolik dhe diastolik (Dickinson, Mason, Nicolson, Campbell, Beyer, Cook, Williams & Ford, 2006).

### **2.3.6 Kufizimi i Alkoolit**

Kufizimi i Alkoolit paraqet një faktor të rëndësishëm për të ulur presionin e gjakut (Xin, Frontini, Ogden, Motsamai & Whelton, 2001). Një analizë tregoi se marrëdhënia në mes dozës së marrë të alkoolit dhe uljes së konsumit të tij, rezultoi në uljen 3 mm Hg të presionit sistolik dhe mmHg të presionit diastolik të gjakut për pacientët të cilët reduktuan alkoolin (Chobanian, Bakris, Black, Cushman, Green, 2003).

### **2.3.7 Ndryshimet Dietare**

Plani i ngrënies së DASH përshkruan një dietë të pasur me fruta dhe perime, produkte të shëndetshme kryesisht bimore, produkte të qumështit me pak yndyrë, kalium, magnez dhe kalcium dhe yndyrna të ngopura totale (*N Engl J Med*, 1997).

### **2.3.8 Humbje peshe**

Humbja e peshës është shumë e rëndësishme në uljen e presionit të gjakut. Një zbritje në peshë mund të ndihmojë në uljen e presionit të gjakut ose parandalimin e hipertensionit. Një ulje prej afërsisht (9 kg) mund të rezultojë në një ulje të presionit sistolik të gjakut prej 5 deri në 20 mm Hg (Chobanian, 2003).

### **2.3.9 Moskonsumi i duhanit**

Përdorimi i cigares shkakton një rritje prej 4 mmHg në presionin sistolik të gjakut dhe një rritje prej 3 mmHg presionin diastolik (Benowitz, Hansson & Jacob, 2002). Konsumi i duhanit është një faktor rreziku i dokumentuar mirë për sëmundjen e hipertensionit, sëmundjet kardiovaskulare (American Heart Association, 2004).

## **2.4 Produktet detare**

Vitamina C, acidet yndyrore omega-3, koenzima Q10 dhe magnezi janë pohuar nga shumë prova për të ulur presionin e gjakut dhe të cilat janë të preferueshme dhe nuk kanë ndonjë efekt të dëmshëm (Schneider, 2005).

### **2.4.1 Meditimi**

Meditimi përfshin një larmi teknikash, siç janë përsëritja e një fjale ose fraze dhe vëmendja e kujdesshme ndaj procesit të frymëmarrjes, për të arritur një gjendje qetësie të brendshme, shkëputje dhe përqendrim të cilat paraqesin një metodë mjaft ndikuese për këtë sëmundje. Meditimi ndihmoi uljen e presionit të gjakut në një studim të dizajnuar mirë që adresonte në mënyrë adekuate matjet e tensionit të gjakut (Schneider, Staggars, Alexander, Sheppard, Rainforth & Kondwani, 1995). Megjithëse studime të tjera kanë qenë jo konsistente (Canter, Ernst, 2004).

#### 2.4.2 Aktiviteti fizik

